



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:146912

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05696447

PKR.nr.6/2005

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues Fatos Sejdiqaj, bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Tahiri, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.I. nga Skenderaji, për shkak të veprës penale-Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (më tej:LPK-së), lidhur me nenin 19 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (më tej:LPJ-së), duke vendosur sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.65/2004, të datës 11.01.2005, sipas detyrës zyrtare me datën 16.05.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

I.- HEDHET aktakuza e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.65/2004, e datës 11.01.2005, dhe **Pushohet** procedura penale ndaj të pandehurit :

A.I., nga i ati Sh....., e ëma, lindur më datë, në fshatin, komuna e Skenderajit ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal, për veprën penale-Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së, **për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.**

II.- Në mbështetje të nenit 276 par.1 të KPP-së, URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i thikës. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, kjo thikë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

III.- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

IV.- Pala e dëmtuar D.S. nga Skenderaji, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

- Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.65/2004, të datës 11.01.2005, ndaj të pandehurit A.I. për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së.

- Me këtë çështje penale Kryetari i Trupit Gjykses është ngarkuar me datën 19.01.2024 dhe pasi që ka pranuar këtë lëndë duke shikuar në shkresat e lëndës ka vërejtur se, në këtë çështje penale për veprën penale-Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së, për të cilën akuzohet i pandehuri, ka arritur afati i parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

- Në rastin konkret i pandehuri është akuzuar për kryerjen e veprës penale-Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së, për të cilën veprë penale parashihet **dënim me burgim jo më pak se pesë vjet.**

- Duke qenë se nuk është përcaktuar maksimumi i dënimit për këtë veprë penale, atëherë në këtë rast zbatohet maksimumi i përgjithshëm i dënimit me burg, parashikuar në nenin 38, paragrafi 1 të LPJ-së i cili përcakton se : *“Dënimi me burg nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e as më i gjatë se pesëmbëdhjetë (15) vjet”*, që nënkupton se maksimumi i dënimit në këtë rast është pesëmbëdhjetë (15) vjet.

- Në nenin 95 par.1, nënpar.2 të LPJ-së, është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar pesëmbëdhjetë (15) vjet nga koha e kryerjes së veprës penale të dënueshme me shumë se dhjetë (10) vjet burgim. Ndërkaq, sipas nenit 96 par.1 të LPJ-së, është përcaktuar *“ parashkrimi i ndjekjes penale fillon që nga data kur është kryer vepra penale”*, ndërsa paragrafi 3 përcakton *“parashkrimi ndërpritet me cdo veprim procesual që ndërmerret për ndjekjen e kryesit për shkak të veprës penale”*.

- Gjykata, nga shkresat dhe provat që gjenden në këtë lëndë penale si dhe nga rrethanat e këtij rasti, konstaton se nuk është paraqitur asnjë nga rrethanat që do të ndalonte rrjedhën e parashkrimit relativ të ndjekjes penale, në afatin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, afat ky i paraparë për parashkrim relativ për veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës.

- Sipas aktakuzës, i pandehuri këtë veprë penale dyshohet ta këtë kryer **me datën 19.11.2002**, ndërsa veprimi i fundit i ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale është data 30.05.2005, datë kjo kur me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P.nr.6/2005 është konfirmuar aktakuza dhe nga kjo datë, e deri më tani, nuk është ndërmarr asnjë veprim në drejtim të ndjekjes penale.

- Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nga data 30.05.2005, datë kur me Aktvendimin e cekurë më lartë është konfirmuar aktakuza, e deri më tani kanë kaluar më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vjet, dhe se brenda kësaj periudhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim me qëllim të ndjekjes penale, që do të ndërpriste rrjedhën e afatit të përshkrimit relativ, çka do të thotë se ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale në bazë të nenit 95, par. 1, nënpar 2 të LPJ-së.

- Saktësisht, parashkrimi relativ i ndjekjes penale në këtë rast penal ka arritur me datë 30.05.2020, ditë kjo kur janë mbushur pesëmbëdhjetë (15) vjet nga dita kur është ndërmarrë veprimi i fundit në drejtim të ndjekjes penale, ngase brenda kësaj periudhe kohore nuk është ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit dhe nuk ka përfunduar ndjekja penale.

- Gjykata, bazuar në verifikimet që janë bërë përmes Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës (SQEPK) në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, nga Zyra për Menagjimin e Lëndëve njoftuar me parashtrësën me shkrim P.nr.6/2005 të datës 15.02.2024, ka vërtetuar se ndaj të pandehurit A.I., përveç kësaj lënde janë zhvilluar edhe procedura tjera, respektivisht rezulton i dënuar me aktgjykim të formës së prerë në këto raste :

- a. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, P.nr.128/2003, i plotëfuqishëm nga data 24.11.2005, për veprën penale-Vjedhje nga neni 252 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.
- b. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PM.nr.15/2002, i plotëfuqishëm me datë 16.01.2004, për veprën penale nga neni 8 par.3 lidhur me par.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr.7/01, për të cilën është paraparë dënim me burg deri në 10 vjet ose me të holla deri në 20.000 DM apo që të dyjat së bashku.
- c. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj, P.nr.61/2020, i plotëfuqishëm me datë 12.11.2020, për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr.06/L-74, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

d. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, P.nr.71/2010, i plotëfuqishëm me datë 09.07.2010, për veprën penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 316 par.1 lidhur me par.4, për të cilën është paraparë dënim me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

- Megjithatë, pavarësisht se ky i pandehur është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë në këto raste, Gjykata konstaton se këto raste nuk e kanë ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

- Bazuar në nenin 96, par. 4 të LPJ-së, rrjedhë se afati i parashkrimit ndërpritet kur kryerësi kryen një veprë tjetër penale **me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit**. Referuar aktgjykimeve me të cilat është dënuar, e të cekura më lartë, këto vepra penale me të cilat është dënuar **nuk janë me peshë të barabartë e as më të rëndë me veprën penale sipas kësaj aktakuze**. Pra, këto vepra penale kanë dënueshmëri më të ultë, që nënkupton se nuk e kanë ndaluar rrjedhën e afatit të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

- Gjykata konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale ashtu që, pamundëson ligjërisht që Gjykata të ndërmerrë ndonjë veprim në drejtim të ndjekjes penale e për pasojë është rrethanë që pengon ndjekjen penale, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi që të hedh aktakuzën e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.65/2004, të datës 11.01.2005 dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit A.I., për veprën penale-Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

- Aktvendimin mbi parashkrimin relativ, Gjykata e mori në kuptim të nenit 95 par.1, nënpar.2 të LPJ-së, lidhur me nenin 357 par.1 nën par. 1.3 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (KPP).

- Gjykata vendosi si në pikën –II- të dispozitivit të këtij aktvendimi duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 276 par.1 të KPP-së, ashtu që ndaj të pandehurit A.I. urdhëroi konfiskimin e përhershëm të thikës, e cila pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi, duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

- Vendimin mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, e mori në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 462 par.1 dhe par.3 të KPP-së.

- Nga arsyet e lartcekura e në kuptim të nenit 95 par.1 nënpar.2 të LPJ-së, e lidhur me nenin 357 par.1, nën par.1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

- Departamenti për Krime të Rënda -

PKR.nr.6/2005, me datë 13.05.2024.

Kryetari i Trupit Gjykses,

Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tre (3) ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.